

**PROGRAM KOMBËTAR
PËR
KËRKIM DHE ZHVILLIM**

AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

SISTEMET DHE TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT

Afati 2010–2012

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Titulli: SISTEMET DHE TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT

2. Institucioni Përgjegjës:

AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

3. Institucionet qendrore që bashkëpunojnë:

Programi është i hapur.

4. Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Institucionet Shkencore:

Programi është i hapur.

5. Fusha e veprimtarisë

a) Fushat e veprimtarisë shkencore e zhvilluese ku realizohen objektivat e Programit:

- Kërkimi në fushën e TIK
- Zhvillimi i aplikimeve të TIK
- Mbështetja me infrastrukturë

b) Fushat e veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore ku zbatohen rezultatet e Programit:

- edukimi
- shëndeti
- qeverisja
- biznesi
- siguria
- energjia
- mbrojtja e mjedisit
- trashëgimia kulturore

6. Afati: 2010-2012

7. Financimi total (lekë): **60,000,000**

II. PËRMBAJTJA

1. Gjendja ekzistuese

Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) gjatë viteve të fundit ka shënuar progres të dukshëm. Është rritur numri i përdoruesve të TIK, i përdoruesve të Internetit, i aplikimeve informatike. Në vecanti progress të dukshëm ka patur zhvillimi i infrastrukturës dhe aplikimeve në sektorin publik, me krijimin e rrejtit informatik qeveritar, krijimin e faqeve të Internetit të institucioneve publike qendrore dhe intensifikimin e përdorimit të TIK nga administrata.

Në vëmendje të qeverisë është strategjia kombëtare për TIK, një version i të cilës, i përmirësuar në përputhje me zhvillimet dhe detyrat aktuale, është paraqitur tashmë për diskutim. Vëmendje të vecantë ky dokument i kushton përdorimit të TIK në administratën publike, në veprimtaritë ekonomike, në kujdesin shëndetësor, në sistemin e drejtësisë, në zhvillimin e përmbytjes dixhitale, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe përdorimeve TIK në edukim dhe kërkimin shkencor.

Në vecanti qeveria po punon për shtrirjen e mësimdhënies të informatikes, krijimin e laboratorëve të TIK dhe lidhjen me Internetin të shkollave në mbarë vendin, cka pritet të japë një shtytje të fuqishme përorimit masiv të TIK; por dhe që shtron detyra komplekse për tu zgjidhur dhe hap horizonte të gjera pune kërkimore e zhvilluese.

Sektori i aresimit të lartë është në kulmin e realizimit të procesit të Bolonjes për modernizimin dhe unifikimin e proceseve educative-kërkimore në shkallë pan-evropiane. Ky proces krijon kushte të reja më të mira për zhvillimin e kërkimit shkencor në kuadrin e edukimit universitar dhe pasuniversitar. Vetë strukturat e kërkimit shkencor po i nënshtrohen një reforme të thellë që synon integrimin e tij me edukimin dhe që mendohet të ketë ndikim pozitiv në rritjen cilësore dhe sasiore të kërkimit dhe zhvillimit.

Në kuadrin e proceseve integruese euroatlantike komuniteti akademik është përfshirë në disa projekte të rëndësishme rajonale të financuar nga Komisioni Evropian, projekte që përfaqësojnë shtrirjen e veprimtarisë kërkimore zhvilluese evropiane në rajonin e Ballkanit dhe vendeve rreth tij. Shëmbuj tipikë janë projektet SEEREN dhe SEEREN2 për lidhjen e rrjetave kërkimore educative kombëtare të vendeve ballkanike me rrjetin kërkimor edukativ panevropian GEANT; si dhe SEE_GRID dhe SEE-GRID2 që synojnë transferimin dhe zhvillimin në rajonin e Evropës Juglindore të rezultateve të projekteve evropiane mbi teknologjitë GRID si një përbërës i rëndësishëm i Zonës Kërkimore Evropiane ERA. Teknologjitë GRID mundësojnë shfrytëzimin e burimeve të shpërndara në rrjetin panevropian kërkimor edukativ nëpërmjet pjesëmarrjes në organizatat virtuale evropiane të kërkimit. Rëndësi të veçantë parashikohet të ketë projekti i financuar nga qeveria italiane për krijimin e rrejtit kombëtar akademik (kërkimor edukativ) të vendit.

Në Evropë kërkimi dhe zhvillimi i TIK përbën një objektiv të rëndësishëm politik, gjë që shprehet në rolin e veçantë që kanë TIK në strukturën e Programit Kuadër 7 (FP7). Krahas zhvillimit të teknologjive dhe aplikimeve të reja, në FP7 parashikohet të vazhdojë projekti tashmë shumëvjeçar GEANT që realizon lidhjen e rrjetave akademike kombëtare të vendeve evropiane në një super-rrjet panevropian, si dhe me rrjetat e kontinenteve të tjera.

Pjesëmarja e vendit në Programin Kuadër 7 të Komisionit Evropian, si një veprimtari e rëndësishme që nxit integrimin evropian, mbështetet nëpërmjet pjesëmarjes në projektet SEE-ERA dhe IDEALIST. SEE-ERA synon forcimin e lidhjeve midis institucioneve rajonale për nxitjen e veprimtarive të përbashkëta, ndërsa IDEALIST synon në qarkullimin e informacioneve mbi projekt-propozimet e ndryshme të FP7 dhe nxitet pjesëmarja në to.

Gjatë PKKZH 2007-2009 u punua në drejtimet aktuale të zhvillimit botëror dhe objektivat e qeverisë, për nxitjen e zhvillimeve të reja të TIK dhe përdorimin e tyre, si dhe në zhvillimin e aplikimeve specifike në fushat e gjuhësisë dhe sekretarive mësimore (Universiteti i Tiranës).

Programi kombëtar aktual për kërkimin dhe zhvillimin në fushën e TIK gjatë 2010-2012 përsëri synon, duke u mbështetur në rezultatet e arritura, drejtimet aktuale të zhvillimit botëror dhe objektivat e qeverisë, të nxitë zhvillime të reja të TIK dhe përdorimit të tyre.

2. Motivimi i ndërmarrjes së Programit

Motivi final i programit është zvogelimi i ndarjes dixhitale të Shqipërisë nga vendet e tjera të rajonit dhe ato evropiane, për të shndrruar TIK në një mjet të fuqishëm të progresit të gjishëanshëm të vendit dhe integritit evropian.

Në veçanti programi motivohet nga:

- Rritja e efektivitetit të TIK nëpërmjet përmirësimit të balances midis infrastrukturës tashmë të instaluar dhe në process instalimi, dhe përmbajtjes dixhitale lokale që qarkullon në të.
- Intensifikimi i veprimtarisë kërkuese dhe zhvilluese të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) dhe kërkimore në fushën e TIK
- Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimore me sektorët e tjerë si administrata publike dhe sektori privat; si dhe me institucionet homologe rajonale dhe evropiane.
- Përfshirja e institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimore në realizimin e detyrave përparësore të vendit që lidhen me përhapjen dhe përdorimin e TIK

Këto motive rrjedhin nga dokumenti për strategjinë kombëtare për TIK, nga nismat e qeverisë për informatizimin e shkollave dhe reformimin e kërkimit shkencor në kuadrin e edukimit universitar dhe pasuniversitar.

3. Drejtimet përparësore të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik në fushën e sistemeve dhe teknologjive të informacionit.

Drejtimet e kërkimit dhe zhvillimit përcaktohen në përputhje me objektivat e programit dhe në shërbim të tyre.

- a) Njohja dhe zbatimi në mënyrë krijuese i teknologjive për zhvillimin e aplikimeve të shpërndara. Krijimi i mjediseve të zhvillimit të aplikimeve dhe i gjuhëve specifike.
- b) Njohja e teknologjive të rrjetave informatike dhe të shërbimeve në to, studimi i cilësive dhe i sjelljes së tyre duke konsideruar kushtet konkrete të vendit, projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të shpërndara.
- c) Njohja dhe zhvillimi i TIK për modelimin dhe simulimin në fusha të tjera të shkencës dhe teknologjise, që lidhen me shtrytëzimin e e-infrastrukturës kombëtare, rajonale dhe evropiane.
- d) Studimi i problemeve dhe i teknologjive të mbrojtjes në rrjetat dhe sistemet e shpërndara.
- e) Studimi i aspekteve të veçanta të TIK me interes të dukshëm për kërkimin dhe edukimin e specialistëve të TIK.
- f) Njohja e gjëndjes të zhvillimit të TIK në vënd; si e-infrashtuktra, aplikimet, përmbajtja dixhitale, kualifikimi, kërkesat etj..
- g) Intensifikimi i bashkëpunimit midis njësive kërkimore-zhvilluese në shkallë kombëtare dhe rritja e kontakteve me homologët në rajon dhe Evropë.

4. Objektivat e kërkimit dhe zhvillimit.

Objektivat kryesore të Programit konsistojnë në zhvillimin sa më të shpejtë dhe aplikimin sa më intensiv në fusha nga më të ndryshmet të sistemeve dhe teknologjive të informacionit, me qëllim që të materializohen idetë e paraqitura në seksionin (2) “Motivimi i ndërmarrjes së Programit”:

4.1. Në fushën e edukimit.

- a. Përmirësimi i kualifikimit të njësive të specializuara në fushën e TIK në IAL në kërkimin dhe zhvillimin e TIK të reja.
- b. Përmirësimi i trainimit të nxënësve, studentëve dhe punonjësve në përdorimin e TIK nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes edukative lokale dhe aplikimeve të “e-edukimit”.

4.2. Në fushën e rrjetave informatike.

- c. Zhvillimi i rrjetave informatike ndër-institucionale në shkallë kombëtare, dhe integrimi i tyre në një rrjet kombëtar por të decentralizuar në shërbim të edukimit dhe kërkimit.
- d. Zhvillimi i zgjidhjeve teknologjike integruese si aplikimet e shpërndara dhe GRID, që synojnë forcimin e bashkëpunimit kërkimor zhvillues midis institucioneve dhe me publikun.

4.3. Në fushën e aplikimeve.

- e. Zhvillimi i aplikimeve me fushë të gjërë përdorimi publik.
- f. Zhvillimi i aplikimeve që ndihmojnë drejtpërdrejt në integrimin e edukimit dhe kërkim – zhvillimit me rajonin dhe Evropën.
- g. Krijimi i bazave të të dhënave me rëndësi publike e kombëtare.
- h. Rritja e sigurisë në rrjetat dhe aplikimet e TIK

4.4. Në fushën e teknologjive të reja.

- i. Njohja e teknologjive të reja dhe zhvillimi i zbatimeve të tyre në shërbim të edukimit dhe kërkimit në TIK.
- j. Zhvillimi i veprimtarive promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare mbi TIK në edukim, kërkim dhe zhvillim.

Këto objektiva do të trajtohen në projekte të veçanta të propozuara nga institucionet e interesuara, por duke i dhënë përparësi:

- projekteve ndër-institucionale me përfshirjen e institucioneve të arësimit të lartë dhe atyre kërkimore.
- projekteve që mbështetin pjesëmarrjen në veprimtaritë kërkimore zhvilluese në fushën e TIK në shkallë rajonale dhe evropiane.

Objektivat janë krejt të përgjithshme për të mos kushtëzuar dhe ngushtuar fushën e aplikimit. Është detyrë dhe e drejtë e të gjitha institucioneve/

organizatave të interesuara dhe e individëve të shprehin kërkesat, idetë dhe projektet e tyre. Kriteri i ndër-institucionalitetit me përfshirjen e komunitetit kërkimor synon të forcojë bashkëpunimin kërkimor – zhvillues midis sektorëve publik, të shoqërisë civile dhe atë privat, koordinimin e përpjekjeve, unifikimin e qëndrimeve dhe arritjen e rezultateve sa më optimale.

5. Ndikimi i rezultateve të pritshme në zhvillimin social-ekonomik

Ndikimi i rezultateve të Programit pritet të jete i dukshëm në disa drejtime:

- a. Përmirësimi i shfrytëzimit të TIK në edukim nëpërmjet krijimit të një përmbajtjeje dixhitale dhe aplikimeve për kapjen e saj.
- b. Zhvillimin e aplikimeve të TIK në rrjeta dhe rritjen e sigurisë së tyre.
- c. Përmirësimin e infrastrukturës më rëndësi kombëtare dhe rritjen e shkallës të integritit të saj në strukturat rajonale dhe evropiane.
- d. Forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional midis departamenteve të TIK me njëri tjetrin, si dhe midis tyre dhe institucioneve të tjera kërkimore-zhvilluese.
- e. Intensifikimin e kontakteve me komunitetin kërkimor në rajon dhe atë evropian dhe rritjen e prezencës në projektet evropiane.

III. FINANCIMI

1. Tabela përmbledhëse e financimit të programit.

SISTEMET DHE TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT				
	Gjithsej	Ndare në vite (Mijë Lekë)		
Emërtimi	(Mijë Lekë)	2010	2011	2012
a) Kosto Totale	60,000	20,000	22,000	18,000
b) Financimi i Siguruar				
c) Kërkesa për Financim	60,000	20,000	22,000	18,000

1. Shpenzimet për programin sipas llojit.

Nr.	Lloji i Shpenzimit	Gjithsej (Mijë Lekë)	Totali		Ndare në vite					
			Sig	Kërkuar	2010		2011		2012	
			(S)	(K)	S	K	S	K	S	K
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	Shpenzime Fizibiliteti	26,000		26,000		8,000		10,000		8,000
	a) <i>personeli</i>	19,000		19,000		6,000		7,000		6,500
	b) <i>të tjera</i>	7,000		7,000		2,000		3,000		1,500
2.	Shpenzime Kapitale	30,000		30,000		10,000		10,500		9,000
	c) <i>paisje të mëdha</i>									
	d) <i>të tjera</i>									
	e) <i>ndërtime</i>									
3.	Asistence teknike e huaj									
4.	Shpenzime Funkionimi	4,000		4,000		2,000		1,500		1,000
	a) <i>Grupi i Punës</i>	2,000		2,000		1000		750		500
	b) <i>Ekspertiza</i>	2,000		2,000		1000		750		500
	SHUMA	60,000		60,000		20,000		22,000		18,000

Shënim: Raportet bazë për zërbërthimin e fondeve sipas zërave:

- Kostua e shpenzimeve për administrimin e programit..... 15%
- Kostua e punës ndaj vlerës totale të projektit..... 40%
- Kostua e paisjeve mesatarisht..... 35%
- Kostua e mjeteve të konsumit..... 10%
- Shpenzimet për asistencë teknike të huaj do të parashikohen në projektet e veçanta duke i përfshirë sipas rastit në zërat "shpenzime personeli" dhe "shpenzime kapitale".
- Detajimi i zërit "shpenzime kapitale" në nënzëra do të bëhet sipas projekteve të veçanta.

3. Burimet e Financimit.

Nr.	Emërtimi	Gjithsej (Mijë Lekë)	Totali		Ndarë në vite					
			Sig (S)	Kërkuar (K)	2007		2008		2009	
					S	K	S	K	S	K
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	Fonde buxhetore	60,000		60,000		20,000		22,000		18,000
2.	Fonde jo-buxhetoree									
3.	Fonde nga firmat a) bashkë - financim b) sponsorizim									
4.	Fonde të huaja									
5.	Fonde të tjera									
	SHUMA	60,000		60,000		20,000		22,000		18,000

Shënim: Gërshetimi i financimeve nga Programi dhe nga burime të tjera do të detajohet në projektet e veçanta. Përparësi do të kenë projektet me financim të kombinuar.

3. Paisje të mëdha.

Nr.	Emërtimi i paisjes Qëllimi i përdorimit	Studimi pse kërkohet	Vlera në (000) Lekë

Shënim: Paisjet e çdo lloji do të paraqiten në dokumentat e projekteve të veçanta.

IV. SKEDA INFORMATIVE E PROGRAMIT

<u>SISTEMET DHE TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT</u>				
AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT				
AFATI 2010 - 2012				
MOTIVIMI I PROGRAMIT:				
<p>Zvogelimi i ndarjes dixitale të Shqipërisë për të shndruar TIK në një mjet të fuqishëm të progresit të gjithëanshëm të vendit dhe integritit evropian: Rritja e efektivitetit të TIK nëpërmjet përmirësimit të përmbajtjes dixhitale lokale. Intensifikimi i veprimtarisë kërkuese dhe zhvilluese të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimore në fushën e TIK Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimore me sektorët e tjerë, si dhe me institucionet homologe rajonale dhe evropiane. Përfshirja e institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimore në realizimin e detyrave përparësore të vendit që lidhen me përhapjen dhe përdorimin e TIK</p>				
OBJEKTIVAT KRYESORE				
<p>Përmirësimi i edukimit të specialistëve në njohjen dhe zhvillimin e TIK. Zhvillimi i rrjetave informatike në shërbim të edukimit dhe kërkimit. Zhvillimi i zgjidhjeve teknologjike integruese dhe aplikimet e shpërndara. Krijimi i bazave të të dhënave dhe rritja e sigurisë në rrjeta. Njohja dhe zbatimi i teknologjive të reja në edukim dhe kërkim në TIK. Zhvillimi i veprimtarive promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare mbi TIK.</p>				
REZULTATET E PRITSHME DHE NDIKIMI I TYRE:				
<p>Përmirësimi i shfrytëzimit të TIK në edukim. Zhvillimi i aplikimeve në rrjeta dhe rritjen e sigurisë së tyre. Përmirësimi i infrastrukturës më rëndësi kombëtare. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe i kontakteve në rajon dhe Evropë</p>				

FINANCIMI	GJITHSEJ (Mijë Lekë)	Ndarë në vite		
		2010	2011	2012
Kosto totale	60,000	20,000	20,000	18,000
Financimi i siguruar				
Kërkesa për financim	60,000	20,000	22,000	18,000